



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/ L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës“, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 31.3.2026, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE KLUBIT TË VOLEJBOLLIT**  
**“PRISHTINA”**

**I.**

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare KV “Prishtina” për projektin “Kampionati i Kosovës në Volejboll-Superliga A2025/2026”.

**II.**

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 10,000.00 € (dhjetë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kodi buxhetor i Drejtorisë së Sportit 85086.

**III.**

Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, klubit të volejbollit “Prishtina”, të cilat Komuna e Prishtinës i ndan si mbështetje financiare për ngritjen e kapaciteteve profesionale, zhvillimin e lojtarëve dhe mbarëvajtjen e garave në Superligën A të Kosovës, Kupës së Kosovës, Ligës “Gjergj Kastrioti” dhe aktivitete për grupmoshat U-14, U-16, U-18 dhe U-21.

**IV.**

Pjesë e këtij vendimi është kërkesa me dokumentet përcjellëse, e KV “Prishtina” dhe rekomandimi nga komisioni.

**V.**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtoritë e tjera relevante.

**VI.**

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditën pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-400/04-47982/26, më 02.4.2026

**KRYESUES I KUVENDIT**

